

VENDIM
Nr. 621, datë 1.11.2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 325, DATË 31.5.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGAVE, NIVELEVE TË PAGAVE DHE SHTESAVE TË TJERA MBI PAGË TË ZËVENDËSMINISTRIT, FUNKSIONARËVE TË KABINETEVE, PREFEKTIT, NËNPREFEKTIT, NËPUNËSVE CIVILË DHE NËPUNËSVE NË DISA INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, të shkronjës “h”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe të neneve 7 e 9, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1, të kreut I, bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Në shkronjën “b”, pas emërimit “Avokatura e Shtetit” shtohet “Agjencia e Inovacionit dhe Ekselencës”.

b) Në shkronjën “ç”, pas emërimit “Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve” shtohet “Qendra e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes”.

c) Në shkronjën “d”, pas emërimit “Sekretariati Teknik i Këshillit Ekonomik Kombëtar” shtohet “Agjencia Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e *Startup*-eve dhe Lehtësuesve”.

2. Shkronja “dh”, e pikës 2, të kreut II, shfuqizohet.

3. Në kreun III bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 2 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. Në fjalinë e parë, pas emërimit “Presidenti i Republikës” shtohet “Kryetari i Kuvendit”.

ii. Pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d”, me këtë përmbajtje:

“d) Kryetari i Kuvendit, për këshilltarët e jashtëm të emëruar prej tij, në masën deri në 130 000 (njëqind e tridhjetë mijë) lekë në muaj.”.

b) Pika 4 shfuqizohet.

c) Pas pikës 7/3 shtohet pika 7/4, me këtë përmbajtje:

“7/4. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “ekspert”, “drejtues qendre”, “zëvendëstitullar institucioni” dhe “titullar institucioni” në Agjencinë e Inovacionit dhe Ekselencës janë sipas lidhjes nr. 8/4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

ç) Pas pikës 9/9 shtohet pika 9/10, me këtë përmbajtje:

“9/10. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “ekspert” dhe “titullar i institucionit” në Qendrën e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes janë sipas lidhjes nr. 10/10, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

4. Lidhja nr. 7/3/b zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Në lidhjen nr. 11, pas fjalëve “Specialist në njësitë organizative të përmbajtjes në Agjencinë e Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë” shtohen fjalët “Specialist në njësitë organizative të përmbajtjes në Agjencinë Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e *Startup*-eve dhe Lehtësuesve”.

6. Në lidhjen nr. 12 bëhen këto ndryshime:

a) Emërtesa “Kryetar i degës së financës dhe administrimit në shkollat e Mesme dhe Profesionale” zëvendësohet me “Përgjegjës i sektorit të financës dhe administrimit në Ofruesin e Arsimit dhe Formimit Profesional”.

b) Pas fjalëve “ ... specialist në zyrat vendore të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive ...” shtohen “ ... specialist në Ofruesin e Arsimit dhe Formimit Profesional ...”, me klasë page IV-3.

II. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi:

a) për përcaktimet që lidhen me Agjencinë e Inovacionit dhe Ekselencës, me përjashtim të titullarit të Agjencisë, si dhe për përcaktimet që lidhen me qendrat e ekselencës në ministri dhe institucionet qendrore të varësisë fillojnë nga data 1 janar 2024 dhe përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion;

b) për titullarin e Agjencisë së Inovacionit dhe Ekselencës fillojnë nga data e emërimit të nëpunësit në detyrë dhe për vitin 2023 përballohen nga fondet e Kryeministrisë;

c) për të gjitha parashikimet e tjera fillojnë me hyrjen në fuqi të këtij vendimi dhe për vitin 2023 përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion për këtë vit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 7/3/b

Klasat e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve në Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar

Pozicioni	Klasa e pagës	Grupi i diplomës
Kancelar.	I-1	1
Ekspert në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.	I-3	1
Drejtor i drejtorive të përmbajtjes. Drejtor drejtorie me funksione të nëpunësit zbatues, sipas legjislacionit të menaxhimit buxhetor e financiar.	II-1	1
Drejtor i drejtorive mbështetëse.	II-2	1
Përgjegjës sektori.	III-1	1
	III-2	
Specialist.	IV-1	1 ose 2
Specialist.	IV-2	1 ose 2 ose 3
	IV-3	

Lidhja nr. 8/4

Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “ekspert”, “drejtues qendre”, “zëvendëstitullar institucioni” dhe “titullar institucioni” në Agjencinë e Inovacionit dhe Ekselencës

Pozicioni	Klasa e pagës	Grupi i diplomës	Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune) (lekë/muaj)
Titullar i institucionit.	I-2	1	90 000
Zëvendëstitullar institucioni. Drejtues qendre.	I-4	1	70 000
Ekspertë.	II-1	1	50 000
Drejtor i drejtorive mbështetëse.	II-2	1	0
Përgjegjës sektori në sektorët mbështetës.	III-2	1	0
Specialist në sektorët apo drejtoritë mbështetëse.	IV-2	1 ose 2 ose 3	0
	IV-3		0

Lidhja nr. 10/10

Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “ekspert” dhe “titullar i institucionit” në Qendrën e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes

Pozicioni	Klasa e pagës	Grupi i diplomës	Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune) (lekë/muaj)
Titullar i institucionit.	I-4	1	70 000
Ekspertë.	II-1	1	50 000
Përgjegjës sektori në sektorët mbështetës.	III-2	1	0

Specialist në sektorët apo drejtoritë mbështetëse.	IV-2	1 ose 2 ose 3	0
	IV-3		0